

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7124
E premte, 23 shkurt 2024
Çmimi 0.50 €

BE-ja konfirmon se i ka ftuar Kosovën dhe Serbinë të bisedojnë për dinarin

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

BUJAR OSMANI, KANDIDAT I BDI-së PËR PRESIDENT TË MAQEDONISË SË VERIUT

FAQE 4-5



Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka bërë me dije të enjten se ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, do të jetë kandidat i BDI-së për president të këtij shteti.

Ahmeti ka thënë se zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale janë të një rëndësie vendimtare, duke u bërë thirrje qytetarëve të rreshtohen me BDI-në. Ai e ka paraqitur kërkesën për instalimin edhe të

postit të zëvendës-presidentit të Maqedonisë së Veriut që, sipas tij, së bashku me presidentin, në të ardhmen të zgjedhen nga Kuvendi i Maqedonisë së Veriut, dhe jo në zgjedhje të drejtpërdrejta

PAGA TË DYFISHTA DHE KONTRATA FIKTIVE: KU SHKOI BUXHETI I KOSOVËS PËR KOMUNAT SERBE?

F. 3



TAHIRI: NUK I VOTOJMË MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE, VENDIN DUAM TA DËRGOJMË NË ZGJEDHJE

F. 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



KUVENDI I SHOQPËRISË RATIFIKON MARRËVESHJEN ME ITALINË PËR EMIGRANTËT

F. 2

13 TË RINJ NGA BALLKANI PERËNDIMOR VIZITUAN JAPONINË

F. 6

KMDLNJ: TË HETOHET ME URGJENCË VDEKJA E KATËRVJEÇARES

F. 7

EKONOMI



EMËROHEN KRYESHEFI EKZEKUTIV DHE ZËVENDËSKRYESHEFI EKZEKUTIV I KEK-ut

F. 8

MUNDËSITË E INVESTIMEVE DHE BASHKËPUNIMIT EKONOMIK U PROMOVUAN PARA DIASPORËS NË SHBA

F. 6

SPORT



LLAPI I AFROHET VETËM ME NJË PIKË DALLIM BALLKANIT

F. 10

Kuvendi i Shqipërisë ratifikon marrëveshjen me Italinë për emigrantët

IRANË, 22 SHKURT - Kuvendi i Shqipërisë me 77 vota për ka ratifikuar marrëveshjen për emigrantët të nënshkruar me Italinë më 6 nëntor të vitit 2023. Sipas Marrëveshjes për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit, Italia do t'i dërgojë në Shqipëri emigrantët që i kap dhe i shpëton në Detin Mesdhe, duke filluar nga pranvera e këtij viti. Kjo marrëveshje është miratuara edhe në Itali nga Dhoma e Ulët e Parlamentit dhe nga Senati.

Veç deputetëve të Partisë Socialiste në pushtet, votën pro kësaj marrëveshjeje e dhanë edhe tre deputetët e Partisë në opozitë për Drejtësi Integrim dhe Unitet (PDIU). Deputetja e PDIU-së, Mesila

Doda, tha se të gjithë duhet të kishim votuar për marrëveshjen, pasi Italia është një vend mik që, sipas saj, ka ndihmuar gjithnjë Shqipërinë në momente krizash. Ndërkaq, deputetët që i përkasin Partisë Demokratike zyrtare e bojkotuan seancën parlamentare për shkak të kundërshtive për Projektligjin e paraqitur në Kuvend për amnistinë penale. Në votim për marrëveshjen nuk morën pjesë as deputetët e "Rithemelimit", edhe pse ishin të pranishëm në sallë.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, nuk ishte pjesë e punimeve të Kuvendit, ndërsa në rrjetin social X, që më herët njihet si "Twitter", ai shkroi se Shqipëria veçoi si një vend



anëtar i Bashkimit Evropian. "Asnjë vend nuk mund ta zgjidhë një sfidë të tillë i vetëm, asnjë retorikë apo zgjidhje e shpejtë nuk mund ta ndryshojë madhësinë e saj dhe asnjë lavdi e vjetër apo mënyra e të

menduarit të kaluar nuk mund të sigurojë një shpëtim nga përballja me atë që po vjen në të gjitha frontet", tha Rama. Marrëveshja parasheh që Shqipëria të strehojë deri në 36 000 emigrantë për një vit, në dy

qendra brenda shtetit, përderisa Italia t'i shqyrtojë kërkesat e tyre për azil.

Partitë opozitare, si në Shqipëri dhe në Itali, e kanë kundërshtuar marrëveshjen. Në Shqipëri, opozita e dërgoi në Gjykatë Kushtetuese marrëveshjen me pretendimin se binte ndesh me Kushtetutën. Gjykata e rrëzoi kërkesën e opozitës, duke i hapur rrugë kështu ratifikimit të marrëveshjes në Kuvend.

Ndërsa në Itali, opozita e konsideroi marrëveshjen një propagandë të shtrenjtë të qeverisë para zgjedhjeve evropiane që do të mbahen më vonë gjatë vitit, dhe një përpjekje të turpshme për ta shndërruar Shqipërinë në një "Guantanamo" të Italisë.

Ukraina thotë se ka vrarë dhjetëra ushtarë rusë në Herson

KIEV, 22 SHKURT - Ushtria ukrainase e ka pranuar se ka sulmuar një poligon stërvitor në Hersonin e pushtuar, ku trupat ruse po përgatishnin një sulm ndaj një ure në Krinka në bregun e majtë të lumit Dnjepër. Ky ishte sulmi i dytë gjatë kësaj jave që ka lënë të vrarë dhjetëra pjesëtarë të ushtrisë ruse. Në të njëjtën kohë, Kievi ka mohuar pretendimin e ministrit rus të Mbrojtjes, Sergei Shoigu, se forcat ruse kanë marrë nën kontroll urën ukrainase në Krinka. "Kanë qenë të paktën tri sulme të përqendruara te trupat ruse që gjendeshin në poligonin stërvitor afër Novaja Kahovkës", tha për Radion Evropa e Lirë më 22 shkurt, Nataliya Humenyuk, zëdhënëse e forcave mbrojtëse në jug të



Ukrainës. "Ushtria ruse po përgatitej të sulmonte Krinkën, që ata veçse pretendojnë se e kanë kapur... Sipas të dhënave paraprake, komandantët e grupit të Dnjepërit [të forcave ruse] ishin aty. Informacioni ende po verifikohet", shtoi ajo.

Në një deklaratë të ndarë dhënë për Suspilne, Humenyuk tha se të paktën 60 ushtarë rusë ishin vrarë gjatë sulmit.

Rusia nuk ka komentuar për sulmin, për të cilin paraprakisht u raportua në kanalet ukrainase dhe nga blogerët pro-Rusisë në

Telegram, të cilët thanë se ka pasur humbje të mëdha. Një video e sulmit të supozuar, ku shihen tri sulme ajrore, është publikuar në kanalet në Telegram. Megjithatë, ky informacion nuk ka mundur të konfirmohet në mënyrë të pavarur.

Në një takim me presidentin rus Vladimir Putin, më 20 shkurt, Shoigu tha se Krinka "është pastruar", por ushtria ruse tha se deklaratat e tij ishte "falsifikim i fakteve".

Forcat ukrainase në nëntor të vitit 2022 kishin çliruar qytetin e Hersonit dhe pjesën tjetër të rajonit në bregun e djathtë të Dnjepërit, duke i dëbuar trupat ruse përtej lumit. Vitin e kaluar trupat e Kievit, po ashtu, arritën të krijonin një urë në anën e majtë të Dnjepërit, që ka qenë

nën sulme të vazhdueshme ruse.

Sulmi i raportuar ukrainas ndaj forcave ruse në Herson ishte i dyti në ditët e fundit, kur një numër i madh i forcave ruse raportohet se janë vrarë.

Më 21 shkurt BBC në gjuhën ruse raportoi se nga sulmi ukrainas në poligonin stërvitor në Donjeckun e pushtuar nga Moska ishin vrarë të paktën 60 trupa ruse.

As Rusia e as Ukraina nuk kanë komentuar për këtë raportim.

Zëdhënësi i Forcave Ajrore ukrainase, Yuriy Ihnat, tha më 22 shkurt se që kur Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës dy vjet më parë, Moska ka gjuajtur mbi 8 000 raketa dhe ka lëshuar 4 630 dronë, nga të cilët 3 605 janë rrëzuar në caqet brenda Ukrainës.

Revista që e nderoi Navalnyn tërhiqet nga tezgat e Moskës

MOSKË, 22 SHKURT - Një numër i revistës së përjavshme ruse "Sobesednik", kushtuar pjesërisht Alexei Navalnyt, është tërhequr nga tezgat në Moskë, njoftoi bordi i redaktorëve i revistës, teksa autoritetet ruse po vazhdojnë ta luftojnë çdo manifestim publik që e nderon kundërshtarin e ndjerë të Kremlinit.

Vdekja e Navalnyt në një burg të largët të Arktikut u raportua më 16 shkurt, duke nxitur pikëllim

dhe zemërim të madh në Rusi dhe nëpër gjithë botën, pasi autoritetet ruse nuk kanë pranuar t'ia dorëzojnë familjes trupin e Navalnyt duke i rritur dyshimet për shkaktarin e vdekjes së tij.

Zyrtarët rusë thanë se shkaktari ishte sindromi "vdekje e papritur".

Derisa shumica e gazetave të shtypura në Rusi nuk ishin marrë fare me vdekjen e Navalnyt, numri i fundit i

"Sobesednik"-ut, i cili shfaqte një fotografi të Navalnyt duke buzëqeshur në ballinën e revistës, e shoqëruar nga një mbishkrim, "...por ka shpresë!" u lëshua më 21 shkurt.

Ajo përmbante raportime nga përkujtime spontane për vdekjen e Navalnyt në disa qytete ruse dhe komente nga figurat publike, aktivistët për të drejtat e njeriut, gazetarët, si fituesi i Çmimit Nobel për Paqe 2021, Dmitry Muratov.



Bujar Osmani, kandidat i BDI-së për president të Maqedonisë së Veriut

Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka bërë me dije të enjten se ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, do të jetë kandidat i BDI-së për president të këtij shteti. Ahmeti ka thënë se zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale janë të një rëndësie vendimtare, duke u bërë thirrje qytetarëve të rreshtohen me BDI-në. Ai ka paraqitur kërkesën për instalimin edhe të postit të zëvendëspresidentit të Maqedonisë së Veriut që, sipas tij, së bashku me presidentin, në të ardhmen të zgjedhen nga Kuvendi i Maqedonisë së Veriut, dhe jo në zgjedhje të drejtpërdrejta

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

SHKUP, 22 SHKURT - Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) të enjten ka paraqitur Bujar Osmanin kandidat i kësaj partie në zgjedhjet presidenciale në Maqedonisë së Veriut që do të mbahen më 24 prill. Këtë e ka bërë me dije kryetari i BDI-së Ali Ahmeti, nëpërmjet një video-mesazhi teksa ka bërë thirrje për "unitet" për t'i thënë, sipas tij, "Jo Ruisisë, po Evropës". Bujar Osmani aktualisht është ministër i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut dhe nënkryetar i BDI-së. "Zgjedhjet që kemi para nesh, parlamentare dhe presidenciale, janë të një rëndësie vendimtare në këtë betejë. Prandaj dhe në këto zgjedhje kemi vendosur që të kërkojmë nga ju të qëndrojmë bashkë, të rreshtoheni me ne në kërkesën për ndryshimin e Kushtetutës dhe zgjedhjen e presidentit dhe zëvendëspresidentit të shtetit në Kuvend, përfshirjen e komunitetit bullgar dhe të tjerëve në Kushtetutë si dhe t'i themi jo Ruisisë, po Evropës, Para jush, po

bëj zotimin e njëmendtë, që ne nuk do të jemi pjesë e asnjë qeverie e cila nuk e ndryshon Kushtetutën dhe do të dalim në opozitë për t'i luftuar dhe mposhtur këto kërcënime ekzistenciale për vendin tonë. Për këtë, kërkojmë besimin tuaj sepse këto punë duan forcë, parti të fuqishme dhe të vendosur që do t'u bëjë ballë punëve të mëdha të dëshmuara në të kaluarën që ka realizuar premtimet e mëdha, që ka bërë atë që ka thënë. Bujari ka dëshmuar veten në skenën vendore dhe ndërkombëtare dhe ka ngadhënjyer në betejën kundër Ruisisë si dhe ka qenë pjesë e ekipit tonë për ndryshimin e Kushtetutës, anëtarësimin në NATO dhe nisjen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian", ka thënë Ahmeti. Kreu i BDI-së, gjithashtu, ka paraqitur kërkesën për instalimin edhe të postit të zëvendëspresidentit të Maqedonisë së Veriut që, sipas tij, së bashku me presidentin, në të ardhmen të zgjedhen nga Kuvendi i Maqedonisë së Veriut, dhe jo në zgjedhje të drejtpërdrejta. "Me Bujarin po nisim referendumin më të



rëndësishëm të kohës dhe betejën e radhës për ta fituar besimin e qytetarëve që ta zgjedhim presidentin në Kuvend me shumicë të dy të tretave të votave dhe me Badinter, për të realizuar vizionin tonë për president konsensual. Ndryshimi i Kushtetutës, sipas Ahmetit, duhet të bëhet për përfshirjen e pakicës bullgare në preambulën e saj dhe zhbllokimin e procesit të integritimit në BE. Ahmeti ka thënë se BDI-ja nuk do të jetë pjesë e asnjë qeverie të ardhshme e cila nuk do ta pranonte ndryshimin e Kushtetutës së Maqedonisë së Veriut. Kërkesa e BDI-së për zgjedhjen e presidentit në Kuvend është e njëjtë me atë të kandidatit të opozitës shqiptare, Arben Taravari, që u paraqit mbrëmjen

e së mërkurës. Veç kësaj, Taravari tha se ndryshimi duhet ta përfshijë edhe heqjen e termit "20 për qind" për gjuhën shqipe apo ridefinimin e saj si "gjuhë shqipe". "Tani e kemi mundësinë që së bashku ta forcojmë demokracinë konsensuale në mënyrë kushtetuese. Tani mund ta sigurojmë njëherë nga tri postet kryesore shtetërore që me automatizim t'u takojë shqiptarëve si kombi i dytë shumicë në Maqedoni [të Veriut]", tha kandidati për president i opozitës shqiptare. Deklaratat e përfaqësuesve politikë shqiptarë në pushtet dhe opozitë pasojnë momentin kur Lidhja Social Demokrate (LSDM) në pushtet njoftoi të mërkurën se kryesia partiake ka vendosur që presidenti aktual, Stevo Pendarovski, të jetë

kandidat i saj për zgjedhjet presidenciale që do të mbahen më 24 prill. Ndërkohë, partia opozitare maqedonase VMRO DPMNE njoftoi përmes një komunikate se deputetja e kësaj partie, Gordana Siljanovska-Davkova, është e vetmja që ka paraqitur kandidaturën për presidente. Nëse ajo do të hyjë për herë të dytë në garën presidenciale, do të dihet pas konventës së partisë më 2 mars. Kandidaturën për president e ka paraqitur edhe partia E Majta, ndërsa këtë do ta bëjnë edhe disa partia të tjera politike. Zgjedhjet për president të Maqedonisë së Veriut do të mbahen në dy runde: i pari më 24 prill, raundi i dytë do të mbahet së bashku me zgjedhjet parlamentare më 8 maj.

Tahiri: Nuk i votojmë marrëveshjet ndërkombëtare, vendin duam ta dërgojmë në zgjedhje

PRISHTINË, 22 SHKURT - Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, ka thënë se nuk do t'i votojnë marrëveshjet ndërkombëtare me qëllim që të pengohet puna e Kuvendit dhe vendi të shkojë në zgjedhje. Në një deklaram për medie të enjten, ai ka thënë se nuk ka kuptim që të bëhet kuorumi për votimin e marrëveshjeve ndërkombëtare derisa vendi ndodhet nën sanksionet e Bashkimit Evropian. "Nga qershori i viti të kaluar grupi parlamentar i PDK-së nuk e voton asnjë marrëveshje ndërkombëtare. Nuk e ka votuar asnjë ligj në kuadër të Kuvendit me qëllimin e vetëm që të mos krijohet kushte që të



punohet më tutje dhe vendi të shkojë në zgjedhje të

jashtëzakonshme", ka thënë Tahiri, duke shtuar se nuk ka kuptim të

bëhet kuorumi dhe të votohen marrëveshjet ndërkombëtare kur,

sipas tij, vendi ynë është nën sanksione. Sipas Tahirit, shkuarja në zgjedhje të jashtëzakonshme është e domosdoshme, marrë parasysh sanksionet ndërkombëtare. Ai ka thënë se Kosovës i nevojitet qeveri e re "në mënyrë që ta nxjerrim vendin nga ky izolim". "Çdo përpjekje e jona që e bëjmë në Kuvendin e Kosovës është që ta çojmë vendin në zgjedhje të jashtëzakonshme në mënyrë që ta nxjerrim vendin nga izolimi ndërkombëtar dhe nga sanksionet ndërkombëtare. Vendit i duhet një kryeministër i ri, një qeveri e re, dhe pa dyshim që do të vijë nga PDK-ja në mënyrë që ta nxjerrim vendin nga ky izolim dhe të japim një zhvillim", ka theksuar Tahiri.



Paga të dyfishta dhe kontrata fiktive: Ku shkoj buxheti i Kosovës për komunat serbe?

PRISHTINË, 22 SHKURT - Dhjetë komuna me shumicë serbe në Kosovë kanë pranuar, ndër vite, fonde nga buxheti i Kosovës për paga të punëtorëve në sistemin arsimor dhe shëndetësor. Megjithatë, këta dy sektorë në këto komuna punojnë kryesisht nën sistemin e Serbisë dhe pranojnë paga edhe nga buxheti i këtij vendi. REL-i ka gjetur se, në disa raste, buxheti i Kosovës i ndarë për ta, është shpenzuar në forma të dyshimta. V. J., qytetar serb i komunës së Leposaviqit - pjesa veriore e Kosovës - ka pranuar dy paga si punëtor i një shkolle në këtë komunë për së paku dhjetë vjet, deri në vitin 2018. Në dhjetë komuna të Kosovës, që banojnë me shumicë nga serbët, përfshirë Leposaviqin, sistemi arsimor punon sipas planprogramit të Serbisë dhe pranon fonde drejtpërdrejt nga buxheti i Serbisë. Duke folur për Radion Evropa e Lirë, V. J. - identiteti i plotë i të cilit është i njohur për redaksinë - tregon se në vitin 2017 ka marrë një kontratë me

kohë të pacaktuar nga komuna, sipas ligjeve të Kosovës, edhe pse ka pasur një kontratë aktive me sistemin serb. "Edhe para asaj kontrate kemi marrë para [paga nga buxheti i Kosovës]... Atëherë kemi marrë para pa asnjë kontratë. Të gjithë punëtorët [në sistemin serb] kanë marrë para pa kontratë dhe pastaj i kemi marrë kontratat [nga Kosova]", thotë V. J. Në shkurt të vitit 2018, shton ai, pushteti i ri lokal në Leposaviq, i kryesuar atëkohë nga Zoran Todiç i Listës Serbe, ua ka ndaluar të ardhurat nga buxheti i Kosovës, pa ndonjë arsytim, sipas tij. Në institucionet serbe të arsimit në Kosovë, të cilat funksionojnë që nga paslufta më 1999, punëtorët, përveç pagës bazë, marrin edhe një shtesë nga shteti serb - që nënkupton se të ardhurat e tyre sillen nga 900 deri në 1 300 euro në muaj. Paga e mësimdhënësve në sistemin e Kosovës, ndërkaq, është nga 580 deri mbi 600 euro. V. J. thotë se nuk ka marrë

kurrë ndonjë vendim për ndërprerje të kontratës me sistemin e Kosovës. "Ajo pagë [nga buxheti i Kosovës] u është shpërndarë më pas disa njerëzve të partisë [Lista Serbe], që nuk kanë punuar kurrë, por i kanë marrë rrogat", thotë V. J., pa specifikuar se kush saktësisht paguhet me atë pagë. Por, për këtë çështje, V. J. thotë se ka ngritur padi në Gjykatën Themelore të Mitrovicës në fund të vitit 2020. Sipas dokumenteve që ka siguruar REL-i, përmes kësaj padie ai ka kërkuar rikthim retroaktiv të pagave, që kapin vlerën e rreth 11 mijë eurove deri në kohën e padisë. Sipas avokatit mbrojtës të V. J., padia e tij nuk është shqyrtuar ende në Gjykatën e Mitrovicës, dega në Leposaviq - siç duket - për shkak të mungesë së stafit. Punonjësit serbë të institucioneve të Kosovës në veri, përfshirë gjykatat, kanë dhënë dorëheqje në nëntor të vitit 2022 për shkak të një vendimi të Qeverisë së Kosovës për t'i reregjistruar makinat me targa serbe me

targa të Kosovës. Radio Evropa e Lirë ka bërë përpjekje ta kontaktojë ish-kryetarin e Leposaviqit, Zoran Todiç, në lidhje me ndërprerjen e pagesave për punonjësit e arsimit, por deri në publikimin e këtij artikulli ai nuk është përgjigjur. Todiç, i cili, po ashtu, ka dhënë dorëheqje në vitin 2022, është edhe kryetar i Autoritetit të Përkohshëm Komunal të Leposaviqit i cili punon nën sistemin serb. Deri në dorëheqje ai ka marrë dy paga, një nga buxheti i Kosovës, një nga Serbia. Numri i saktë i punëtorëve arsimorë në Leposaviq nuk është publik. As në publikimet vjetore të statistikave të arsimit, Ministria e Arsimit e Kosovës thotë se nuk i ka të dhënat statistikore për arsimin e komunitetit serb në Kosovë. Megjithatë Kosova, çdo vit, ndan buxhet për të 38 komunat e Kosovës, përfshirë për paga dhe shtesa në arsim dhe shëndetësi. E kontaktuar nga REL-i, Qeveria e Kosovës nuk është

përgjigjur në pyetjen nëse e di apo ka monitoruar se si shpenzohet ky buxhet. Nëpërmjet Ligjit për Buxhet që aprovohet çdo vit, Kosova ka ndarë buxhet për paga dhe shtesa në arsim edhe për 10 komunat me shumicë serbe, ku arsimit kryesisht kontrollohet nga Serbia.

Dy sisteme në dy vitrina

As komuna e Leposaviqit, që tani udhëhiqet nga kryetari shqiptar Lulzim Hetemi, nuk ka mundur të japë përgjigje se në çfarë mënyre shpenzohet ky buxhet. Në një vizitë që REL-i bëri në këtë komunë më 15 shkurt, pa se në një zyrë të vogël të objektit disakatësh të komunës ishin renditur dhjetëra dokumente komunale, të ndara në dy vitrina. Një nga vitrinat mbante dokumente të komunës që punonte me ligjet e Kosovës, e tjetra dokumente nga komuna paralele që kontrollohet nga Serbia. Të dyja këto institucione, para

vitit 2022, punonin nga i njëjti objekt.

Hetemi tha se nuk ka informacione se si mund të jetë harxhuar buxheti paraprak i komunës. "Ato [para] nuk e dimë se ku kanë shkuar, sepse nuk kemi qenë kompetentë për t'i shikuar dokumentet. Menjëherë e kam bërë një thirrje që të vijë [policia] e krimeve ekonomike. Që dy muaj e gjysmë janë duke hetuar... janë duke shfletuar dokumentacionin se ku dhe nga kanë shkuar këto para", tha Hetemi për Radion Evropa e Lirë.

Policia e Kosovës konfirmoi për REL-in se ka nisur hetime "rreth keqpërdorimeve në komunën e Leposaviqit" dhe se është në fazën e mbledhjes së dëshmive. "Janë sekuestruar disa dosje", tha policia.

Komuna konfirmoi se aktualisht janë rreth dhjetë persona të punësuar në sistemin arsimor në komunë, nga komuniteti shqiptar, që paguhen nga buxheti i saj. Hetemi tha se po bëhen përpjekje që stafi i shkollave në gjuhën serbe të integrohet në institucionet komunale të Kosovës. "Nëse ata nuk hyjnë në sistemin tonë të komunës, ne ato para [për paga dhe mëditje] do t'i shfrytëzojmë në mënyra të ndryshme. Për shembull, përmes asamblesë, do t'i përdorim diku tjetër", tha ai.

Situata në komunat e tjera

Pjesa më e madhe e komunave me shumicë serbe në Kosovë nuk iu përgjigj pyetjeve të Radios Evropa e Lirë se si shpenzohet buxheti për paga dhe shtesa në sistemin arsimor dhe nëse punëtorët në këtë sistem kanë paga të dyfishta.

Një ndër komunat e vetme që u përgjigj, ajo e Novobërdës, konfirmoi se në këtë komunë janë të punësuar 219 punëtorë të arsimit - 140 që punojnë në shkollat në gjuhën serbe dhe 79 në shkollat shqip. Sipas saj, të gjithë këta punëtorë marrin paga nga buxheti i Kosovës.

Komuna tha se nuk ka informacione nëse punëtorët në shkollat me planprogram serb marrin paga edhe nga buxheti i Serbisë. Por, burime të Radios Evropa e Lirë kanë treguar se në një komunë tjetër me shumicë serbe, në jug të Lumit Ibër, persona që kanë marrë kontrata mësimdhënësish, ushtrojnë në fakt pozita të tjera brenda komunës.

Në komunën e Graçanicës, ndonëse shkollat punojnë në sistemin serb, së voni janë hapur konkurse për punëtorë arsimorë në sistemin e Kosovës.

Një nga konkurset e fundit ishte në tetor të vitit të kaluar, për tre arsimtarë në shkollat fillore që punojnë sipas sistemit serb dhe dy profesorë në një shkollë të mesme dhe

një shkollë të elektroteknikës që, po ashtu, funksionojnë sipas sistemit serb.

Paraprakisht, në maj të vitit 2023 kjo komunë shpalli konkurs për 14 vende pune në shkollat fillore dhe 11 profesorë në shkollat e mesme. Radio Evropa e Lirë ka tentuar të kontaktojë me drejtorët e këtyre shkollave, por në telefon është përgjigjur vetëm drejtori i Shkollës së Elektroteknikës, Millan Dimitrijeviq.

I pyetur nëse në shkollën e tij ka mësimdhënës që e marrin pagën nga buxheti i Qeverisë së Kosovës, ai tha se nuk mund të përgjigjet. "Nuk mund t'ju jap asnjë informacion. Për çdo gjë duhet ta kontaktoni Drejtorinë e Arsimit në Mitrovicë", tha Dimitrijeviq, duke iu referuar një institucioni paralel që udhëheq arsimin e komunitetit serb në Kosovë.

Radio Evropa e Lirë e ka kontaktuar këtë institucion dhe Ministrinë e Arsimit në Qeverinë e Serbisë, e cila është përgjegjëse për sistemin arsimor në komunitetet serbe në Kosovë, por nuk ka marrë përgjigje.

Situatë e ngjashme në fushën e shëndetësisë

Kosova ndan buxhet edhe për punëtorët në sistemin shëndetësor në komunat me shumicë serbe, ndonëse ata punojnë sipas sistemit serb.

Nëpërmjet Ligjit për Buxhet që aprovohet çdo vit, Kosova ka ndarë buxhet për paga dhe shtesa në shëndetësi edhe për 10 komunat me shumicë serbe, ku shëndetësia kryesisht kontrollohet nga Serbia.

Ngjashëm me rastin e V. J., REL-i ka gjetur edhe një rast ku një punëtorë shëndetësorë në Mitrovicën e Veriut - tjetër komunë me shumicë serbe, afër Leposaviqit - ka ngritur padi, pasi paga nga sistemi i Kosovës i është ndërprerë papritur në vitin 2015. Deri atëherë ajo kishte marrë pagë të dyfishtë - edhe nga Kosova, edhe nga Serbia.

Komunat me shumicë serbe në jug të Lumit Ibër shpesh shpallin konkurse për mjekë apo personel tjetër mjekësor, të cilët më pas punësohen në ndonjë institucion shëndetësor që punon në sistemin serb.

Këtë e konfirmoi për REL-in Branimir Stojanoviç, ish-kryetar i Graçanicës dhe ish-zyrtar i Listës Serbe - partisë më të madhe të serbëve në Kosovë. Ai tani është një nga themeluesit e partisë së re të serbëve në Kosovë - Lëvizja Popullore Serbe.

"Ju keni mjekë specialistë, të cilët, p.sh., punojnë në spitalin e Graçanicës. Ndoshta ka pasur ndonjë manipulim me kontratat më parë, por ajo që kemi bërë është se ne kemi shpallur konkurse dhe kështu kemi punësuar njerëz", tha Stojanoviç

dhe shtoi se nuk beson se ka pagesa të dyfishta për këta punëtorë.

Stojanoviç beson se institucionet arsimore dhe shëndetësore në Kosovë duhet të mbeten të lidhura me sistemin serb, sepse ato janë kyçe për mbijetesën e serbëve, sipas tij. Ai tha se problemi i pagesave të dyfishta të rrogave duhet të rregullohet përmes Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, për të cilin është rënë dakord në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi në vitin 2013.

Ky asociacion, i cili nuk është themeluar ende, parashihet të ketë juridiksion në fushën e shëndetësisë dhe arsimit, por edhe në buxhetin e vet, në të cilin do të derdheshin mjete nga Qeveria e Kosovës dhe ajo e Serbisë.

Shteti serb ndan çdo vit miliona euro fonde për Kosovën, megjithëse nuk ka shumë transparencë se si shpenzohen ato fonde.

Vetëm për vitin 2024 janë ndarë afër 140 milionë euro.

Pagat në fushën e arsimit dhe atë të shëndetësisë kalojnë përmes Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, e cila nuk u është përgjigjur pyetjeve të REL-it në lidhje me këtë temë.

Sipas një projektstatuti të hartuar nga Perëndimi për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, institucionet serbe të shëndetësisë dhe të arsimit parashihet të regjistrohen si institucione private.



Mundësitë e investimeve dhe bashkëpunimit ekonomik u promovuan para diasporës në ShBA

NJU-JORK, 22 SHKURT - Një delegacion prej 25 biznesesh nga sektorë të ndryshëm të Kosovës iu bashkuan nismës së Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe Programit Kosovo Compete të USAID-it për promovim të mundësive për investime dhe bashkëpunim ekonomik para përfaqësuesve të bizneseve të diasporës që jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në dy aktivitete të ndara rrjetëzuese dhe të takimeve biznes me biznes, afaristët nga Kosova dhe nga diaspora në

ShBA eksploruan mundësitë e bashkëpunimit në industri të ndryshme si ajo e përpunimit të ushqimit, ndërtimit dhe teknologjisë së informacionit. Përfaqësuesve të bizneseve nga Kosova dhe nga ShBA-ja iu adresuan me fjalime zëvendësndihmësadministrato rja e lartë e USAID-it, Lisa Magno, konsulli i përgjithshëm i Republikës së Kosovës në Nju-Jork, Blerim Reka, si dhe drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka.

Ndërsa Roland Nezaj nga

kompania RLN US LLP dhe Atdhe Deva nga Tech Fusion Ventures folën për përvojën e tyre të investimit në Kosovë, si investitorë nga diaspora. Po ashtu, drejtuesit e lartë të USAID-it dhe të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë mbajtën edhe një tryezë diskutimi me përfaqësues të dalluar të komunitetit afarist shqiptar në ShBA, për të diskutuar lidhur me mundësitë dhe sfidat që karakterizojnë sfidën e investimeve në Kosovë, prej së cilës tryezë u gjeneruan rekomandime të vlefshme.



13 të rinj nga Ballkani Perëndimor vizituan Japoninë

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 22 SHKURT - Pritja në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Japonisë ka shënuar zyrtarisht fundin e rrugëtimit shtatëditor për 13 të rinjtë nga Ballkani Perëndimor të cilët vizituan Tokën e Diellit në kuadër të "Programit të Lidhjeve Shoqërore të Japonisë" - MIRAI. Në bashkëpunim me Qeverinë e Japonisë, RYCO e ka zbatuar këtë projekt për katër vjet radhazi me qëllim të promovimit të mirëkuptimit të ndërsjellë, zgjerimit të diskutimit intelektual dhe ndërtimit të një rrjeti të fortë të liderëve të ardhshëm.

Nga data 13-20 shkurt, 13 të rinj të përzgjedhur përmes një procesi shumë konkurrues me më shumë se 400 aplikues, patën mundësinë të vizitojnë vende të rëndësishme historike dhe institucione arsimore në Tokio dhe Hiroshima, dhe përmes dialogut dhe diskutimeve t'i thellojnë njohuritë e tyre mbi ndërtimin e paqes dhe zgjidhjen e konfliktit.

Gjatë ditëve të para të vizitës, pjesëmarrësit mësuan gjithashtu për përpjekjet e Japonisë drejt ndërtimit të paqes përmes një vizite në Agjencinë Japoneze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (JICA) dhe më vonë, gjatë vizitës së tyre në Hiroshima, ku u angazhuan në një diskutim të



thellë mbi mënyrën se si Japonia u përball me të kaluarën e saj, veçanërisht me pasojat e bombës atomike në Hiroshima. Medinë Dauti, pjesëmarrëse nga Kosova, ndau përshtypjet e saj gjatë kësaj vizite. "Si dikush që vjen nga rajoni i plagosur nga konflikti, turneu i Hiroshimës më shërbeu si një katalizator i fuqishëm për reflektim dhe transformim. Më sfidoi të rimendoj pikëpamjet e mia për

ndërtimin e paqes dhe pajtimin, duke më nxitur të çlirohem nga cikli i dhunës dhe të përqafoj një qasje më të dhembshur dhe gjithëpërfshirëse për zgjidhjen e konflikteve. Përvoja e Parkut Përkujtimor të Hiroshimës jo vetëm që më dha një kuptim më të thellë të pasojave të luftës, por më nguliti një ndjenjë të përtërirë shprese dhe vendosmërie për të kontribuar në ndërtimin e një të ardhmeje

ku mizori të tilla nuk do të përsëriten kurrë. Ishte një udhëtim që jo vetëm që shëroi një pjesë të zemrës sime, por më frymëzoi për të ndjekur në mënyrë aktive paqen në të gjitha aspektet e jetës sime", ka thënë Dauti.

Vizita në Japoni ofroi përvoja unike kulturore, pasi 13 pjesëmarrës, përfshirë studentët të diplomuar dhe universitarë, dhe profesionistë të rinj, patën

mundësinë të mësojnë rreth kaligrafisë dhe të provojnë veten në këtë art të të shkruarit. Ditën e fundit të vizitës, pjesëmarrësit e MIRAI-t bënë një vizitë zyrtare në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Japonisë, ku morën pjesë në seancën raportuese dhe ndanë përshtypjet e tyre rreth programit dhe mësimet e nxjerra gjatë vizitës që do të mund t'i ndajnë me bashkëmoshatarët e tyre pas kthimit në shtëpi.

Në hapësirat e ndërtesës së qeverisë, Kurti mirëpriti nxënësit e Shkollës Fillore "Ismail Qemali"

PRISHTINË, 22 SHKURT - Mëngjesin e së enjtes mysafirë në zyrën e kryeministrit patën rastin të jenë një grup nxënësish të Shkollës Fillore "Ismail Qemali", të cilët u pritën ngrohtësisht nga kryeministri i Albin Kurti.

Kureshtjes dhe interesimit të shfaqur gjatë takimit nga shkollarët e vegjël, kryeministri Kurti iu përgjigj duke ndarë me nxënësit kujtime nga fëmijëria e tij, si dhe përvoja nga jeta

profesionale në pozitën e kryeministrit. "I lumtur, e sidomos kur njerëzit e tjerë bëhen të lumtur që po ju ndihmoj dhe shërbej si kryeministër i Republikës së Kosovës", u shpreh ai në pyetjen se si ndihet në pozitën e kreut të qeverisë.

Fëmijët e klasës së parë të shoqëruar nga mësuesja Filloreta Mustafa Dërmaku falënderuan kryeministrin Kurti për

mundësinë dhe kohën për t'u takuar derisa nxënësit, përveç momenteve të këndshme e gazmore, i dhuruan kryeministrin edhe një punim arti të realizuar nga dora e tyre.

Gjatë këtij takimi nxënësit e vegjël patën rastin ta vizitojnë ndërtesën e qeverisë dhe të njihen nga afër me ambientet e punës, përfshirë sallën e mbledhjeve të kabinetit qeveritar dhe Qendrën për Media.



BE-ja konfirmon se i ka ftuar Kosovën dhe Serbinë të bisedojnë për dinarin

PRISHTINË, 22 SHKURT - Bashkimi Evropian (BE) konfirmoi të mërkurën se i ka thirrur Kosovën dhe Serbinë për një takim më 27 shkurt në Bruksel për të biseduar për çështjen e dinarit, pasi Banka Qendrore e Kosovës në fillim të këtij muaji e ndaloi përdorimin e tij për pagesa me para të gatshme, tha zëdhënësi i BE-së, Peter Stano. "Përfaqësuesi i lartë Joseph Borrell pati takime me presidentin [e Serbisë Aleksandar] Vuçiç dhe kryeministrin [e Kosovës Albin] Kurti në Munihi javën e shkuar, ku u diskutua kjo çështje. Si rrjedhojë e këtij takimi, i dërguari i posaçëm Mirosllav Lajçak i ftoi dy palët që të vijnë

në Bruksel më 27 shkurt", tha Stano, raporton Rel. Të mërkurën zëvendës-kryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, tha se e refuzoi një ftesë të Brukselit për të biseduar lidhur me çështjen e ndalimit të dinarit serb në Kosovë. "Ky nuk është takim ku duhet të shkojë kryenegociatori për arsye se çështja e dinarit nuk është pjesë e dialogut. Unë shkoj atëherë kur bisedohet për Marrëveshjen Bazike", tha Bislimi. Bislimi tha se Lajçaku, me dërgimin e kësaj ftese, kishte shkelur "parimet që i ka vendosur vetë" pasi, sipas tij, "është hera e parë që ai ka

caktuar një takim pa pajtim paraprak me palët dhe është munduar ta përcaktojë agjendën përkundër parimet që ai ka vendosur në vitin 2021, që asnjë temë nuk vendoset në agjendë pa pajtimin e palëve". Stano e kritikoi deklaratën e Bislimit për Lajçakun si të "papranueshme" dhe tha se festa e të dërguarit të posaçëm të BE-së nuk specifikonte se kush prej cilës palë duhej të merrte pjesë në takimin e ftuar nga ai për 27 shkurt. "Zakonisht nuk i komentojmë shkëmbimet me partnerët tanë. Megjithatë, ftesa përmes letrës nga i dërguari i posaçëm Lajçak nuk kishte specifikuar se kush duhet ta përfaqësojë Kosovën



dhe kush Serbinë. Kjo u ishte lënë palëve të vendosin" ka thënë Stano. Ai tha se BE-ja po bën përpjekje për të gjetur një zgjidhje për

problemin e krijuar nga "vendimi i pakoordinuar i njërës palë, i cili nuk i ishte komunikuar paraprakisht popullatës në të cilën ndikon".

Nënshkruhet memorandumi i bashkëpunimit për studime albanologjike ndërmjet MASHTI-t dhe Universitetit të Prishtinës

PRISHTINË, 22 SHKURT - Në Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, nën praninë e kryeministrit Albin Kurti, është nënshkruar memorandumi bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Universitetit të Prishtinës, për zhvillimin dhe promovimin e albanologjisë, me theks të veçantë në programet e gjuhës shqipe dhe letërsisë shqipe. Kryeministri Kurti gjatë fjalës së tij në ceremoni bëri me dije se qëllimi i këtij memorandumi është përkrahja financiare e stafit akademik të Universitetit të Prishtinës për publikime në revistat që botohen nga Fakulteti i Filologjisë dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës. "Veçanërisht, Ministria do ta përkrahë stafin akademik të Fakultetit të Filologjisë për artikujt shkencorë në fushën e albanologjisë në revistat me faktor ndikimi. Gjithashtu, do t'i mbulojë edhe shpenzimet për pjesëmarrje në Seminare



Ndërkombëtare. Do të ndajë bursa vjetore në vlerë prej 1 000 eurosh për studentët që

studiojnë gjuhën dhe letërsinë shqipe", shtoi tutje ai. Ndër të tjera, do të ofrohet

mbështetje vjetore për tri projektet shkencore të realizuara nga stafi akademik i Fakultetit të

Filologjisë në kuadër të studimeve albanologjike. Përkrahje të tillë ky memorandum u ofron edhe dy projekteve hulumtuese më të suksesshme të studentëve në nivelin master, si dhe garave në nivel parauniversitar për mendim kritik, argumentim dhe drejtshkrim.

Me këtë rast kryeministri Kurti uroi që zbatimi i këtij Memorandum Bashkëpunimi të sjellë përfitime për stafin akademik dhe studentët, njëkohësisht të prodhojë rezultate origjinale e të vjera për studimet albanologjike.

Të pranishëm në ceremoninë e nënshkrimit të memorandumi bashkëpunimit ishin Arbërie Nagavci, ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Qerim Qerimi, rektori i Universitetit të Prishtinës, prorektorë të UP-së, Lindita Rugova, dekane e Fakultetit të Filologjisë dhe staf akademik dhe studentë të Universitetit të Prishtinës.

KMDLNj: Të hetohet me urgjencë vdekja e katërvjeçares

Prishtinë, 22 shkurt - Një katërvjeçare ka vdekur në QKUK më 19 shkurt, dy ditë pasi ishte sjell nga Spitali i Gjakovës për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka bërë thirrje që të hetohet me urgjencë vdekja e katërvjeçares. "Kjo ngjarje e rëndë ngre pikëpyetje serioze për përmeshjen e përgjegjëseve njerëzore, mjekësore etike të profesionistëve të kujdesit

shëndetësor. Sipas raportimeve dhe dyshimeve të ngritura nga prindërit e vajzës të cilat janë transmetuar në medie, e ndjera dyshohet se ka pësuar një sulm nga dy fëmijë të tjerë, duke u goditur me forcë në pjesën e shpinës dhe gjoksit, gjë që ka çuar edhe në rrëzimin e saj në rrugë. Megjithë gjendjen e rënduar të fëmijës, prindërit janë shprehur se përgjigja mjekësore ndaj gjendjes së saj ka qenë e pamjaftueshme dhe jo në përputhje me

standardet profesionale. Prindërit pretendojnë se gjatë se kanë kërkuar disa herë ndihmë mjekësore për vajzën e tyre, por kanë marrë vetëm disa këshilla sipërfaqësore nga ekipi mjekësor, duke nënvlerësuar gjendjen e saj. Sipas prindërve, vajza nuk ka marrë një ekzaminim të plotë mjekësor dhe trajtimi i duhur i saj është neglizhuar duke shkaktuar fatalitet, gjë që ngre shqetësim dhe pikëpyetje të thella në lidhje me etikën profesionale të personelit mjekësor", është thënë në



reagimin e KMDLNj-së. KMDLNj bën thirrje që institucionet përgjegjëse, në përmeshje të mandatit të tyre, ta trajtojnë me prioritet

absolut rastin dhe t'i ndërmarrin në mënyrë të menjëhershme veprimet dhe masat e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi.

ASK-ja del me shifra se sa u prodhuan rrymë në Kosovë e sa u harxhua

PRISHTINË, 22 SHKURT - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar "Statistikat e Energjisë" për muajin dhjetor 2023 me të dhëna për prodhimin dhe konsumin e thëngjillit, prodhimin dhe konsumin e energjisë, importin dhe eksportin e energjisë, si dhe importin dhe eksportin e energjentëve të tjerë. Në raportin e ASK-së thuhet

se më shumë energji elektrike ka pasur në dispozicion në dhjetor 2023 krahasuar me muajin e njëjtë në vitin 2022. "Gjatë muajit dhjetor të vitit 2023 energjia elektrike bruto në dispozicion ishte 853.83 GWh, kurse konsumi i energjisë elektrike ishte 608.16 GWh ose 12,69 % më i madh sesa në muajin e njëjtë të vitit paraprak

(dhjetor 2022)", thuhet në raport.

ASK-ja ka bërë me dije se pjesëmarrja e energjisë elektrike alternative në kuadër të konsumit të përgjithshëm ishte 13,34 %. Ndërkaq, rënie duket se ka shënuar prodhimi i thëngjillit. "Prodhimi i thëngjillit ishte rreth 7.21 mijë tonë ose 1,45 % më pak se në muajin e njëjtë të vitit



Emërohen kryeshefi ekzekutiv dhe zëvendëskryeshefi ekzekutiv i KEK-ut

PRISHTINË, 22 SHKURT - Bordi i Drejtorëve i KEK-ut ka emëruar kryeshefin ekzekutiv dhe zëvendëskryeshefin e KEK-ut. "Bordi i Drejtorëve të KEK sh.a njofton se në pozitën e kryeshefit ekzekutiv (ushtrues detyre) në Korporatën Energjetike të Kosovës është emëruar Bekir Gërguri. Sot gjatë ceremonisë së pranim-dorëzimit Gërguri ka pranuar detyrat dhe autorizimet e plota për udhëheqjen e të gjitha operacioneve të KEK sh.a. Bordi i Drejtorëve i KEK sh.a. gjithashtu ka emëruar Ramadan Budakovën në pozitën e zëvendëskryeshefit ekzekutiv (ushtrues detyre) dhe njëkohësisht Përparim Kabashi është kthyer në detyrat dhe

përgjegjësitë e tij të cilat i ka ushtruar para emërimit të tij në pozitën e zëvendëskryeshefit ekzekutiv (ushtrues detyre)", ka njoftuar KEK-u, duke theksuar se Bordi i Drejtorëve të KEK-ut është i përkushtuar për qeverisjen e korporatës në përputhje me përgjegjësitë dhe kompetencat që rrjedhin nga Ligji për Ndërmarrjet Publike, si dhe parimet e njohura ndërkombëtare për qeverisjen korporative të ndërmarrjeve publike. "Bordi i Drejtorëve të KEK-ut, duke iu uruar suksese në detyrat dhe përgjegjësitë e reja Gërgurit dhe Budakovës, ka falënderuar edhe z. Kabashi për angazhimin e tij të deritanishëm", ka njoftuar KEK-u.

KEDS-i zë 259 konsumatorë duke e vjedhur rrymën gjatë një muaji

PRISHTINË, 22 SHKURT - Vetëm përgjatë muajit janar 2024, KEDS-i ka zënë 259 konsumatorë në flagrancë duke e vjedhur energjinë elektrike. Afër 130 mijë euro është shuma që këta konsumatorë janë të obliguar t'ia rikthejnë kompanisë si humbje të shkaktuara në rrjet. Ndërkaq, vlera totale e kilovatëve që këta konsumatorë e kanë vjedhur gjatë muajit janar është afër një milion e gjysmë. "Dëmi i shkaktuar ndaj KEDS-it nga këta konsumatorë të pandërgjegjshëm është i madh, njëjtë siç është e madhe edhe përgjegjësia financiare dhe ligjore që këta e kanë ndaj kompanisë dhe institucioneve të Drejtësisë. Konsumatorët që kapen duke e

vjedhur energjinë elektrike, pos obligimit që t'i rikthejë humbjet, dërgohen nga KEDS-i edhe në gjykatat kompetente. Sepse, vjedhja e energjisë elektrike hyn në kuadër të 'Vjedhjes së Shërbimeve', çka sipas nenit 314 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës është e dënueshme deri në tri vjet burg", ka njoftuar KEDS-i.

Në vitin 2023 KEDS-i ka dorëzuar mbi 2 300 raste në gjykatat e Kosovës.

KEDS-i ka njoftuar se mbetet i pakompromis ndaj të gjithë konsumatorëve që e keqpërdorin energjinë elektrike dhe, së fundi, ka shtuar kontrollet ditore anëmbanë Kosovës.



Elldin Uglari emërohet zëvendësministër i Zhvillimit Rajonal

PRISHTINË, 22 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin

Kurti, ka emëruar Elldin Uglari, zëvendësministër të Zhvillimit

Rajonal. Kryeministri Kurti e uroi Uglarin për detyrën dhe i dëshiroi

suksese në përmbushjen e përgjegjësisë të reja.



Të varfër dhe të lumtur: Shoqëritë që sfidojnë tendencat e kënaqësisë së jetës



Në një studim të kohëve të fundit, studiuesit pyetën 3000 njerëz që jetojnë në shoqëri të varfra dhe të vogla, për kënaqësinë që marrin nga jeta. Rezultatet zbuluan se e kanë të njëjtë me atë të njerëzve që jetojnë në vendet më të pasura. Një arsye e mundshme pse gëzimet e thjeshta si ndërveprimi shoqëror dhe jeta në natyrë luajnë një rol të jashtëzakonshëm në kënaqësinë që marrin nga jeta komunitetet e vogla, është se shumë prej këtyre shoqërive nuk fitojnë para me tepri.

Melanezët që jetojnë në rajonet Roviana dhe Gizo të Ishujve Solomon janë një nga popujt më të varfër në botë. Ata kanë një mënyrë jetese, ku i plotësojnë nevojat e tyre me peshkim dhe bujqësi. Herë pas here, shesin mallrat e tyre në tregun lokal për të blerë ushqime të përpunuara ose për të paguar tarifën e shkollimit të fëmijëve. Lukset e jetës moderne – telefonat inteligjentë, interneti, TV, dyshekët “me kujtesë” – janë të vështira për t’u gjetur. Por pavarësisht kësaj ekzistence të thjeshtë nga pikëpamja materiale, melanezët shprehin se janë më të

kënaqur nga jeta, sesa banorët e Finlandës dhe Danimarkës, të cilët zënë rregullisht titujt e mëdhenj të gazetave, si popujt më të lumtur në botë. Një nga gjetjet më interesante në studimin e lumturisë është lidhja midis të ardhurave, pasurisë dhe kënaqësisë nga jeta. Sa më shumë para të ketë dikush, aq më i kënaqur priret që të jetë. Sa më i pasur një vend, aq më të lumtur qytetarët e tij. Por, siç po mësojnë sot shkencëtarët, disa popuj e sfidojnë këtë tendencë. Popujt – shpesh indigenë – që jetojnë në komunitete të vogla dhe të

izoluara priren të jenë po aq të kënaqur me jetën e tyre, sa njerëzit që jetojnë në vendet më të pasura. Zbulimi i arsyes mund të na volisë të gjithëve.

Pasuria dhe kënaqësia nga jeta


Pikërisht ky objektiv frymëzoi studimet e botuara në revistën shkencore, “Proceedings of the National Academy of Sciences”. Shkencëtarët nga Universiteti Autônoma de Barcelona në Spanjë dhe Universiteti McGill në Kanada udhëtuan nëpër botë për të pyetur rreth 3000 pjesëtarë të 19 shoqërive të varfra dhe të vogla, me vendbanime në 18 vende të ndryshme. Ata vizituan Kumbungut në Gana, Laprakët në Nepal, Vavateninët në Madagaskar dhe Lonkuimajët në Kili, mes shumë të tjerëve. Udhëtimi shkencor u zhvillua në kuadër të një projekti më të madh, i fokusuar në ndryshimet klimatike, por studiuesit vlerësuan gjithashtu kënaqësinë e jetës së këtyre popujve të vegjël. “Mesatarja e kënaqësisë nga jeta

në mesin e 19 shoqërive të anketuara është 6.8 nga 10, edhe pse shumica e tyre kanë të ardhura vjetore prej më pak se 1000 dollarë amerikanë për person,” raportuan studiuesit. Vlerat kaq të larta të kënaqësisë nga jeta zakonisht shihen vetëm në vendet ku PBB për frymë tejkalon 40,000 dollarë në vit. Atëherë, çfarë e shpjegon këtë kërcim drejt një niveli më të lartë lumturie? Antropologët perëndimorë që kanë vizituar komunitete të vogla, kanë zbuluar se në përgjithësi, këta njerëz marrin një kënaqësi të madhe nga aktivitete të thjeshta si dëgjimi i muzikës, shëtitjet ose thjesht relaksimi. Marrëdhëniet me miqtë dhe familjen, si dhe socializimi sjellin gjithashtu shumë gëzim. Anëtarët e komunitetit gjithashtu priren të vlerësojnë shumë kalimin e kohës në natyrë. Studime të shumta tregojnë se të qenit jashtë në habitate të paprekura nga zhvillimi përmirëson humorin, shëndetin dhe mirëqenien e përgjithshme. Një arsye e vetëkuptueshme pse gëzimet e thjeshta, si ndërveprimet sociale dhe të

jetuarit në natyrë uajnë një rol të jashtëzakonshëm në nxitjen e kënaqësisë nga jeta në komunitetet e vogla, është se shumë prej këtyre shoqërive nuk fitojnë shumë para. Në studimet e mëhershme, anëtarët e të njëjtit ekip të Barcelonës dhe McGill vizituan shoqëri të tjera të vogla dhe krahasuan mirëqenien e tyre kolektive. Ata zbuluan se në komunitetet ku paraja luante një rol më të madh, nxitësit e lumturisë ndryshonin: njerëzit kalonin nga shijimi i aktiviteteve në kontakt me natyrën, tek prioritizimi i faktorëve socialë dhe ekonomikë. Paratë sillnin lumturi, dhe jo kënaqësi të thjeshta të jetës. Konkluzioni, sipas zbatuesve të këtij studimi, është se kënaqësia nga jeta “nuk kërkon norma të larta të konsumit të gjërave materiale, të lidhura përgjithësisht me të ardhura e larta monetare”. Pasi plotësojnë nevojat themelore si njerëz – si strehimi, ushqimi dhe siguria – gëzimin mund ta gjejnë tek njerëzit dhe vendet përreth nesh. / *Big Think – Bota.al*



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Në Deçan ndeshja e parë, derbi i madh në Ferizaj

Prishtinë, 22 shkurt - Sot (e premte) dhe nesër (e shtunë) luhen ndeshjet e xhiros së 17-të të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt). Ndeshja e parë është të premtën nga ora 19:00, ndërsa vë përballë Deçanin e Trepçën. Skuadra mitrovicase vlerësohet

favorite. Ndërkohë gjithë vëmendja do të jetë në Ferizaj, ku të shtunën nga ora 19:00 zhvillohet derbi i madh në mes të Kastriotit dhe Rahovecit. Bëhet fjalë për dy prej skuadrave që synojnë trofetë e këtij edicioni garues. Rahoveci është i pandalshëm këtë

edicion. Ka fituar të gjitha 16 ndeshjet e deritashme dhe udhëheq në tabelë me 32 pikë. Por "vreshtarët" pritet të sfidohen seriozisht në palestrën "Bill Clinton" të shtunën mbrëma. Kastrioti ka bërë përforsime të shumta në afatin kalimtar të janarit dhe ka shpallur

kandidaturën për titull kampioni. Ndeshja pritet të jetë e fortë dhe dramatike deri në fund. Të shtunën janë edhe dy ndeshje të tjera. Vushtrria e Prishtina takohen nga ora 15:00 në kryeqytet, ndërsa Vëllaznimi dhe Besa Famgas luajnë prej orës 19:00 në Gjakovë.



Llapi i afrohet vetëm me një pikë dallim Ballkanit

Klubi i drejtuar nga Tahir Batatina po shkëlqen në pranverë. Me fitoren e fundit ndaj Fushë-Kosovës, i është afruar skuadrës lidere, Ballkanit, me vetëm një pikë dallim. Fitore të enjten ka shënuar edhe Dukagjini ndaj Lirisë

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 22 SHKURT - Skuadra e Llapi ka shënuar fitore të madhe në ndeshjen ndaj Fushë-Kosovës me rezultat 3-0, e vlefshme për javën e 21-të në Albi Mall Superligën e Kosovës. Pas kësaj fitore skuadra e drejtuar nga Tahir Batatina i është afruar liderit aktual, Ballkanit, me vetëm një pikë. Hamdi Namani ka realizuar golin e parë në minutën e 23-të, ndërsa në pjesën e parë tri gola iu anuluan Muhamet Hysenit, për pozita jashtë loje pas rishikimit të VAR-it.

Hysani shënoi golin e dytë në minutën e 57-të. Në pjesën e dytë Ilir Blakqori (68') vulosi rezultatit final

të ndeshjes 0-3. Llapi me tri pikët e reja renditet në vendin e dytë në tabelë, kurse Fushë-Kosova është e nënta me 11 pikë. Të enjten tri pikët ka rrëmbyer edhe skuadra e Dukagjinit në minutat shtesë në përballje me skuadrën e Lirisë (2-1). Skuadra nga Klina e mbylli pjesën e parë me epërsi 1-0. Autor i golit ishte Iljasa Zulfiji. Në pjesën e dytë Liria ishte skuadër më e mirë, duke krijuar më shumë shanse shënimi. Prizrenasit në minutën e 70 e barazuan rezultatit me golin e realizuar nga mbrojtësi Rigon Spahiu (1-1). Në minutat shtesë, Dukagjini fitoi penallti pas rikthimit të VAR-it. Fillimisht portieri Stivi Frashëri e priti goditjen e Gentrut Salihu, por gjyqtari e ktheu



penalltinë, të cilën kësaj radhe e ekzekutoi Blerind Morina, të cilit gjithashtu ia priti portieri, por nga topi i kthyer shënoi golin e fitores 2-1. Dukagjini me tri pikët e reja ka grumbulluar 30 pikë dhe zë pozitën e gjashtë, ndërsa Liria mbetet e fundit me 10 pikë.

Të mërkurën skuadra e Dritës e ka mposhtur në derbin e javës së 21-të

në Ballkanin e Suharekës (1-0). Golin e vetëm në këtë ndeshje e shënoi Juan Mesa. Fitore të rëndësishme dhe të dytë në këtë edicion në përballje direkte arriti Malisheva ndaj Prishtinës me rezultat 0-2. Në minutën e 33-të Altin Aliu realizoi për 0-1, kurse dy minuta pa përfunduar ndeshja rezultatit final 0-2 e vulosi futbollisti në topformë

SUPERLIGA

Fushë Kosova - Llapi	0-3
Dukagjini - Liria	2-1
Prishtina - Malisheva	0-2
Drita - Ballkani	1-0
Feronikeli 74 - Gjilani	0-0

Tabela

		Pikë
1. Ballkani	21	44
2. Llapi	21	43
3. Drita	21	40
4. Malisheva	21	35
5. Prishtina	21	30
6. Dukagjini	21	30
7. Feronikeli 74	21	23
8. Gjilani	21	21
9. Fushë Kosova	21	11
10. Liria	21	9

Drilon Hazrollaj. Në ndeshjen e tretë që u zhvillua të mërkurën mes Feronikelit 74 dhe Gjilanit nuk pati fitues, pasi ndeshja përfundoi me rezultat 0-0.

Bardh Krasniqi emërohet drejtor i sportit në komunën e Prishtinës



PRISHTINË, 22 SHKURT - Bardh Krasniqi është emëruar në pozitën e drejtorit të Drejtorisë së Sportit në komunën e Prishtinës. Krasniqi në këtë pozitë e zëvendëson Granit Rugovën. Lajmin e ka konfirmuar përmes një postimi në "Facebook", kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama. "Të dashur qytetarë dhe dashamirës të sportit, me shumë kënaqësi ju njoftoj me drejtorin e ri të

Sportit në kryeqytet, Bardh Krasniqi. Bardhi, një ish-basketbollist i shquar në skenën vendore e ndërkombëtare, vjen në këtë pozitë si profesionist për ta çuar edhe më përpara fushën e sportit. Ai do të punojë në ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës sportive në kryeqytet, për ta mundësuar zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme e të shumta këtë vit në Prishtinë tonë, e shpallur "Qytet i Sportit", ka thënë

Rama. "Bardhi do të angazhohet për realizimin e projekteve për ta bërë kryeqytetin gati për 'Lojërat Mesdhetare 2030', gjë që jemi të bindur se do t'ia arrijë fal sukseseve akademike në Stamboll dhe profesionalizmit të tij të treguar ndër vite në themelimin, menaxhimin e shumë kompanive dhe projekteve në fushën e telekomunikimit brenda dhe jashtë vendit", ka shtuar Rama.

Cannavaro kritikon Rrahmanin për golin e shënuar nga Lewandowski

NAPOLI, 22 SHKURT - Napoli barazoi ndaj Barcelonës me rezultat 1-1 në kuadër të fazës eliminuese të Ligës së Kampionëve. Në fakt, napolitanët ishin në disavantazh me golin e

Robert Lewandowskit në minutën e 60, por e arritën barazimin me Victor Osimhen 15 minuta më vonë. E për golin e pësuar të ekipit italian ka folur Fabio Cannavaro, i cili e ka fajësuar

mbrojtësin Amir Rrahmani. "Nëse një mbrojtës e lë topin të kalojë nëpër këmbët e tij, siç bëri Rrahmani në fillim dhe Di Lorenzo më vonë, ju po vrisni efektivisht portierin tuaj. Rregulli

numër një për një mbrojtës është të mos lejosh kurrë që ai top të kalojë nëpër këmbët e tua. Detyra juaj parësore është ta ndaloni topin të dalë", ka thënë ish-mbrojtësi italian.



Asani: Jemi më të fortë se kurrë më parë, do të jetë viti ynë

TIRANË, 22 SHKURT - Viti 2023 ishte më i miri në karrierën e Jasir Asanit. Futbollisti shqiptar nga Maqedonia e Veriut shkëlqeu në fanellën e Kombëtares shqiptare, të cilën me golat dhe kontributin e tij e ndihmoi që të kualifikohej në Kampionat Evropian. E tash,

futbollisti ofansiv do ta nisë vitin 2024 me ambicie të mëdha, si me klubin e tij ashtu edhe me kuqezinjtë. Ndonëse pritej një rikthim i tij në futbollin evropian, 28-vjeçari mbeti në Korenë e Jugut, respektivisht në ekipin Gwngju FC. Ish-futbollisti i Vardarit, Shkupit,

Pobedas, Partizanit, AIK e Kisvarda, e ka bërë një postim në rrjetet sociale, përmes të cilit i ka shprehur ambiciet e tij për vitin 2024, duke shprehur optimizëm se ky do të jetë një vit pozitiv dhe i suksesshëm për të dhe për shqiptarët në përgjithësi. "Jemi gati për

sezonin e ri më të fortë se kurrë më parë. Do të jetë viti ynë", ka shkruar Asani në rrjetet sociale. Kombëtarja shqiptare e siguroi kualifikimin e dytë në një Kampionat Evropian brenda tetë vjetësh, ndërsa në "Euro 2024" ka përfunduar në grup me Spanjën, Italinë dhe Kroacinë.



Kroos: Do të luaj sërish për Gjermaninë

MADRID, 22 SHKURT - Të shumta ishin aludimet, por më në fund tifozët e Kombëtares së Gjermanisë kanë diçka për t'u gëzuar. Pas një pushimi trevjeçar, lideri i mesfushës së "Pancerave", Toni Kroos, është rikthyer te katër herë kampionët e botës, për një "vallëzim të fundit" në Kampionatin Evropian të Futbollit "Euro 2024", i cili zhvillohet në Gjermani. Vendimi për rikthimin në Kombëtare ka ardhur nga vetë veterani i mesfushës, së "Galaktikëve" të Real Madridit, me "arkitektin" 34-vjeçar, i cili me anë të një postimi, në profilin e tij zyrtar në "Instagram", ka lumturuar jo pak besnikët e "Pancerave", të cilët prej thujse 10 vitesh tashmë po shohin rënien e lirë të Kombëtares. "Djema, shkurt: nga marsi do të luaj sërish



për Gjermaninë. Pse? Për shkak se më pyeti trajneri i Kombëtares dhe unë pranova. Jam i bindur se kjo skuadër në 'Euro' është e aftë për shumë më tepër nga sa mendojnë

shumica e njerëzve!", ka shkruar fituesi i Kupës së Botës me Gjermaninë në vitin 2014, i cili duket i bindur për ta bërë surprizën në këtë Evropian.

Red Bulli më i shpejti, Verstappenin 'flutoron' në testin e parë të sezonit

BAHRAIN, 22 SHKURT - Pritja po shkon drejt fundit dhe më 29 shkurt kampionati më prestigjioz i automobilizmit, Formula 1, do të çelë siparin e sezonit 2024. Gjithçka do të nisë në pistën e Bahreinit, vend në të cilin aktualisht kanë nisur edhe provat e para për këtë vit, teksa në ditën e parë të testimeve, makina Red Bull e kampionit në fuqi të botës, Max Verstappen, u konfirmua si më e shpejta. "Tulipani" ua la "targën" rivalëve në prova duke rezultuar 1.1 sekonda më i shpejtë se McLaren i britanikut Lando Norris, teksa kohën e tretë më të mirë e realizoi spanjulli Carlos Sainz me "kokëkuqen" e Ferrari, teksa shumë larg pritshmërive u shfaqën Leclerc e Hamiltoni, edhe pse duhet theksuar se ishte vetëm dita e parë e provave. Pas këtyre testeve në Bahrein, Max Verstappen u shfaq tejet i lumtur, ndërsa theksoi se i kishte munguar ndjesia e të garuarit në Formula 1. Më tej tri herë



kampioni i botës në Formula 1 foli edhe për makinën, teksa u shpreh se "vetura" e tij e re ishte e shpejtë, e balancuar dhe u përgjigjej mirë veprimeve të "tulipanit". "Është ndjesi shumë e bukur të rikthehem sërish. Ishte një ditë e këndshme, provuam disa gjëra të

reja me makinën dhe jam i lumtur në përgjithësi. U argëtova në pistë. Makina është e shpejtë, e balancuar dhe u përgjigjej mirë. Sigurisht që bëhet fjalë vetëm për testime, por mbeta shumë i kënaqur", u shpreh piloti holandez.

SHKURT

Partizani shijon fitoren e parë në Ligën Unike

Partizani ka shënuar fitoren e parë në këtë edicion të Ligës Unike Femrat. Kampioni mundi Flamurtarin e Vlorës me rezultat 51:55 (13:17, 12:14, 13:11, 13:13). Periudha e parë ishte e barabartë, por tiranaset për një nuancë ishin më të mira dhe e fituan këtë pjesë 13:17. Mysafiret thelluan epërsinë në 12 pikë, 14:26, por vlonjatet rikthehen dhe pjesa e parë përfundon 25:31. Lojë interesante dhe e barabartë u zhvillua në pjesën e dytë, por Partizani ishte më i vëmendshëm dhe ruajti epërsinë për ta shënuar fitoren e parë 51:55. Selena Camaj ishte më e mira te vendaset me 22 pikë e nëntë kërcime, kurse Emma Fee te mysafiret me 13 pikë dhe 17 kërcime. Flamurtari ka dy fitore e tri humbje, kurse Partizani një fitore e katër humbje.

Alvesi dënohet 4 vjet e 6 muaj burg

Gjykata e Katalunjës ka dënuar me 4 vjet e 6 muaj burg ish-futbollistin e Barcelonës, Daniel Alves, pasi e shpalli fajtor për përdhunimin e një gruaje në një klub nate në kryeqendrën e Katalonjës. 40-vjeçari, i cili është një prej futbollistëve me më shumë trofe të fituar në karrierë, i ka mohuar gjithmonë akuzat. Ngjarja raportohet të ketë ndodhur më 31 dhjetor të vitit 2022. Gjykata, gjithashtu, urdhëroi brazilianin që t'i paguajë viktimës 150 mijë euro dëmshpërblim. "Vendimi u mor pasi u vërtetua që viktima nuk kishte qenë dakord për kryerjen e marrëdhënieve seksuale dhe ka dëshmi që vërtetojnë përdhunimin", citon Reuters vendimin e gjykatës. Prokuroria kishte kërkuar dënimin me 9 vjet burg për brazilianin. Alves gjithmonë ka deklaruar se gruaja kishte pranuar më dëshirë për të kryer marrëdhënie me të.

Messi dhe Inter Miami e nisin me fitore sezonin e ri në MLS

Inter Miami ka fituar me rezultat 2-0 ndaj Real Salt Lake në ndeshjen e parë të sezonit 2024 në Major League Soccer (MLS). Ekipi i Lionel Messit me shokë ka shfrytëzuar mirë pushimin dhe ndeshjen e parë si vendas për të nisur me fitore sezonin e ri në ligën elitare të futbollit të ShBA-së. Pjesa e parë e ndeshjes u karakterizua me dominim të Inter Miamit, i cili, përveç rasteve të shumta, arriti ta shënojë edhe një gol. Goli i vetëm në këtë pjesë erdhi në minutën e 39 dhe ishte Robert Taylor, i cili shënoi për 1-0 pas asistimit të Messit. Në pjesën e dytë mysafirët ishin skuadër më e mirë duke krijuar më shumë, por vendasit e menaxhuan mirë lojën dhe në fund shënuan edhe një gol. Goli i dytë erdhi në minutën e 83-të dhe ishte Diego Gomez i cili vulosi rezultatin përfundimtar 2-0 pas asistimit të Luis Suarezit. Në ndeshjen e ardhshme Inter Miami luan në udhëtim te Los Angeles Galaxy.

Arteta: Jam shumë i zhgënjyer si e dhamë ndeshjen në fund

Arsenali është mposhtur nga Porto në ndeshjen e parë të Ligës së Kampionëve në këtë fazë të eliminimeve. Goli i vetëm i takimit u shënuar në minutën e 94-të të ndeshjes, ndërsa trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, është shprehur i zhgënjyer me rezultatin. "Jam shumë i zhgënjyer si e dhamë ndeshjen në fund, nuk e menaxhuan mjaft mirë atë situatë. Ju dënoheni në Ligën e Kampionëve. Nëse nuk mund ta fitoni atë, atëherë s'mund ta humbni", ka thënë Arteta, i cili më tej ka shtuar se ekipi i tij dominoi në lojë, por i mungonte qëllimi për t'i konkretizuar rastet.

Lewandowski pas barazimit ndaj Napolit: Fitojmë në Barcelonë

Robert Lewandowski dhe Victor Osimhen shënuan në barazimin 1-1 mes Napolit dhe Barcelonës në duelin e parë të raundit të 1/8-ve në Ligën e Kampionëve. Sulmuesi i

skuadrës katalanase, Lewandowski, u shpall lojtari më i mirë i ndeshjes në "Diego Maradona". Në analizën pas ndeshjes polaku ka thënë: "Pjesa e parë ishte e shkëlqyer për

ne. E dyta më pak, edhe prej faktit që u mbrojtëm. Gjithsesi arritëm të shënonim. Siguroam një barazim që na krijon mundësi të mëdha për t'u kualifikuar. Duhet të fitojmë në

Barcelonë, sepse është shumë e rëndësishme. Forma ime? Ndihehem shumë mirë fizikisht. Kemi shumë lojtarë të rinj. Na duhet pak kohë, por skuadra ka shumë potencial.

Unë sjell eksperiencë, ndërkohë që kemi lojtarë si Pedri që gjithmonë duan të tregojnë diçka më shumë. Luajmë të bashkuar ndaj Napolit, të vazhdojmë kështu përpara".



SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës: Zyrtar i ri për Analiza buxhetore, kontroll dhe kontabilitet të shpenzimeve
Grada e pozitës: shtatë (7)
Kohëzgjatja e punësimit: me afat të pacaktuar
Departamenti: i Financave
Divizioni: i Buxhetit dhe Raportimit Financiar
Raporton tek: Udhëheqësi i Divizionit të Buxhetit dhe Raportimit Financiar

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Përgatit dhe rifreskon t' dhënat (materialet) që kanë të bëjnë me buxhetin dhe kontabilitetin e shpenzimeve;
- Përgatit raportet ditore dhe periodike të shpenzimeve faktike për qëllime të Kontabilitet të shpenzimeve (kostos) dhe analizave buxhetore përkatëse;
- Përgatit paradhëniet për udhëtime zyrtare dhe përgatit dokumentacion për aprovimin e paradhënies dhe shpenzimeve për udhëtimet zyrtare në vend dhe jashtë vendit;
- Përkujdeset në implementimi i buxhetit sipas njësive shpenzuese /departamenteve, divizioneve/për shpenzimet e trajnimeve/studimeve dhe udhëtimeve zyrtare në bazë të politikave dhe procedurave të aprovuara për buxhet dhe kontabilitet të shpenzimeve (kostos);
- Përgatit raportet analizat e në lidhje me pikën paraprake në baza të rregullta ditore;
- Ndhmon në zhvillimin e sistemit të analizës buxhetor, në përputhje me kërkesat për shfrytëzimin e buxhetit dhe alternativat;
- Ndhmon në përgatitjen e rregullave dhe procedurave të punës dhe përgjegjësi në përputhje me përshkrimin e vendit të punës;
- Përgatit analiza buxhetore lidhur me të hyrat dhe shpenzimet, për zërat specifik të tyre;
- Zëvendëson Zyrtarin e për Analiza Buxhetore dhe kontroll kur mungon duke realizuar detyrat ditore të tij/saj;
- Kryen punë tjera të ndërlidhura ashtu sipas kërkesave të mbikëqyrësit dhe vijës tjetër hierarkike.

Njohurit e kërkuara:

- Diploma e Universitetit në Ekonomi, Financa, Kontabilitet, Menaxhim Afarist apo Matematikë Financiare dhe të ngjajshme;
- Preferohet të këtë certifikim në kontabilitet (në shoqatat profesionale vendore dhe/ose ndërkombëtare);
- Njohuri të mira të punëve bankare paraqet përparësi;
- Njohuri të mira në Excel dhe Word, si dhe preferohet të këtë përvojë pune me aplikacione (bankare) të kontabilitetit;
- Preferohet njohuri të mira të Gjuhës Angleze.

Përvoja e kërkuar:

- Preferohet 1 (një) vit përvojë pune në bankë/financa/buxhetim, kontabilitetin financiar dhe kontabilitetin e shpenzimeve.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **8 mars 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



RASPISIVANJE KONKURSA ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naziv radnog mesta: Novi službenik za analizu budžeta, kontrolu i računovodstvo rashoda
Nivo stepena: Sedam (7)
Trajanje radnog odnosa: Na neodređeno vreme
Odeljenje: Finansija
Odsek: Za budžet i finansijsko izveštavanje
Izveštava: Rukovodiocu Odseka za budžet i finansijsko izveštavanje

Sažetak dužnosti i odgovornosti:

- Priprema i ažurira podatke (materijale) koji se odnose na budžet i računovodstvo troškova;
- Priprema dnevne i periodične izveštaje o stvarnim troškovima za potrebe Računovodstva troškova (rashoda) i odgovarajuće analize budžeta;
- Priprema avanse za službena putovanja i priprema dokumentaciju za odobravanje avansa i troškova službenih putovanja u zemlji i inostranstvu;
- Stara se da sprovođenje budžeta bude prema potrošačkim jedinicama/odeljenjima, odsecima/za troškove obuka/studija i službenih putovanja na osnovu politika i procedura odobrenih za budžet i računovodstvo troškova (rashoda);
- Priprema izveštaje i analize u vezi sa prethodnom tačkom na redovnom dnevnom nivou;
- Pomaže u razvoju sistema analize budžeta, u skladu sa zahtevima za korišćenje budžeta i alternativama;
- Pomaže u pripremi radnih pravila i procedura i odgovornosti u skladu sa opisom radnog mesta;
- Priprema analize budžeta u vezi sa prihodima i troškovima, za njihove specifične stavke;
- Zamenjuje Zvaničnika za analizu i kontrolu budžeta kada je odsutan obavljanjem njegovih/njenih dnevnih obaveza;
- Obavlja druge povezane poslove prema zahtevima supervizora i druge hijerarhijske linije;

Potrebna znanja:

- Univerzitetska diploma iz ekonomije, finansija, računovodstva, poslovnog menadžmenta ili finansijske matematike i slično;
- Poželjna je sertifikacija iz računovodstva (u lokalnim i/ili međunarodnim profesionalnim udruženjima);
- Dobro poznavanje bankarstva predstavlja prednost;
- Dobro poznavanje Excel-a i Word-a i iskustvo u radu sa (bankarskim) računovodstvenim aplikacijama je poželjno;
- Dobro poznavanje engleskog jezika je poželjno.

Potrebno iskustvo:

- Preferohet 1 (një) vit përvojë pune në bankë/financa/buxhetim, kontabilitetin financiar dhe kontabilitetin e shpenzimeve.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK-a za apliciranje;
- Prateće (motivaciono) pismo gde se naglašava interesovanje za ovu poziciju;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju da budu zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Postupak podnošenja aplikacije:

- Zadnji rok za podnošenje aplikacija je **8 mart 2024** godine.
- Aplikacija se može podneti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik apliciranja neće biti uzet u razmatranje.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti sa zvanične stranice: www.bqk-kos.org



SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Zyrtar për Analiza buxhetore dhe kontroll
Grada e pozitës:	gjashtë (6)
Kohëzgjatja e punësimit:	me afat të pacaktuar
Departamenti:	i Financave
Divizioni:	i Buxhetit dhe Raportimit Financiar
Raporton tek:	Udhëheqësi i Divizionit të Buxhetit dhe Raportimit Financiar

Përmbledhje e Detyrave dhe Përgjegjësi:

- Përgatit dokumentacionin për verifikimin e evidencës së plotë të proceseve për dokumentet e pagueshme;
- Përgatit parashëniet për udhëtime zyrtare dhe përgatitë dokumentacion për aprovimin e parashënies dhe shpenzimeve për udhëtimet zyrtare në vend dhe jashtë vendit;
- Përkujdeset në implementimi i buxhetit sipas njësive shpenzuese /departamenteve, divizioneve/për shpenzimet e trajnimeve/studimeve dhe udhëtimeve zyrtare në bazë të politikave dhe procedurave të aprovuara për buxhet dhe *kontabilitet të shpenzimeve (kostos)*;
- Përgatit raportet analizat e lidhje me pikën paraprake në baza të rregullta ditore;
- Ndihmon në draftimin e rregullave dhe procedurave të punës së divizionit ku punon në kuadër të përgjegjësi dhe përshkrimit të vendit të punës;
- Ndihmon në zhvillimin e sistemit të analizës buxhetore, në përputhje me kërkesat për shfrytëzimin e buxhetit dhe alternativat;
- Ndihmon në mbajtjen dhe rifreskimin të 'dhënave (materialet) që kanë të bëjnë me buxhetin dhe kontabilitetin e shpenzimeve;
- Përgatit analiza financiare/buxhetore lidhur me të hyrat dhe shpenzimet, për zërat specifik të tyre;
- Zëvendëson Zyrtarin e ri për kontabilitet të shpenzimeve kur mungon duke realizuar detyrat ditore të tij/saj;
- Kryen punë tjera të ndërlidhura sipas kërkesave të mbikëqyrës dhe vijës tjetër hierarkike.

Edukimi, njohuritë dhe përvoja e kërkuar:

- Diploma e Universitetit në Ekonomi, Financa, Kontabilitet, Menaxhim Afarist ose Matematikë Financiare apo të ngjashme;
- Së paku 2 vite përvojë pune në bankë/financa/buxhetim, kontabilitetin financiar dhe kontabilitetin e shpenzimeve;
- Preferohet të këtë certifikim profesional në kontabilitet ose auditim (në shoqatat profesionale vendore dhe ndërkombëtare);
- Njohuri të mira të punëve bankare paraqet përparësi;
- Njohuri të mira të aplikacioneve (bankare) të kontabilitetit, njohuri të mira në shfrytëzimin e bazës së të dhënave të aplikacioneve, Excel dhe Word;
- Preferohet njohuri të mira të Gjuhës Angleze.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **8 mars 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



RASPISIVANJE KONKURSA ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naziv radnog mesta:	Službenik za analizu i kontrolu budžeta
Nivo stepena:	Šest (6)
Trajanje radnog odnosa:	Na neodređeno vreme
Odeljenje:	Finansija
Odsek:	Za budžet i finansijsko izveštavanje
Izveštava:	Rukovodiocu Odseka za budžet i finansijsko izveštavanje

Sažetak dužnosti i odgovornosti:

- Priprema dokumentaciju za verifikaciju kompletne evidencije procesa za plativa dokumenta;
- Priprema avanse za službena putovanja i priprema dokumentaciju za odobranje avansa i troškova službenih putovanja u zemlji i inostranstvu;
- Stara se da sprovođenje budžeta bude prema potrošačkim jedinicama/odeljenjima, odsecima/za troškove obuka/studija i službenih putovanja na osnovu politika i procedura odobrenih za budžet i *računovodstvo troškova (rashoda)*;
- Priprema izveštaje i analize u vezi sa prethodnom tačkom na redovnom dnevnom nivou;
- Pomaže u izradi radnih pravila i procedura rada odseka gde radi u okviru odgovornosti i opisa radnog mesta;
- Pomaže u razvoju sistema analize budžeta, u skladu sa zahtevima za korišćenje budžeta i alternativama;
- Pomaže u održavanju i ažuriranju podataka (materijala) koji se odnose na budžet i računovodstvo troškova;
- Priprema finansijske i analize budžeta u vezi sa prihodima i troškovima, za njihove specifične stavke;
- Zamenjuje novog Službenika računovodstva troškova kada je odsutan obavljanjem njegovih/njenih dnevnih obaveza;
- Obavlja druge povezane poslove prema zahtevima supervizora i druge hijerarhijske linije;

Potrebno obrazovanje, znanje i iskustvo:

- Univerzitetska diploma iz ekonomije, finansija, računovodstva, poslovnog menadžmenta ili finansijske matematike i slično;
- Najmanje 2 godine radnog iskustva u bankarstvu/finansijama/budžetiranju, finansijskom računovodstvu i računovodstvu troškova;
- Poželjna je sertifikacija iz računovodstva ili revizije (u lokalnim i/ili međunarodnim profesionalnim udruženjima);
- Dobro poznavanje bankarstva je prednost;
- Dobro poznavanje (bankarskih) računovodstvenih aplikacija, dobro poznavanje korišćenja aplikacija baza podataka, Excel-a i Word-a;
- Dobro poznavanje engleskog jezika je poželjno.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK-a za apliciranje;
- Prateće (motivaciono) pismo gde se naglašava interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili uverenja poslodavca ili druge relevantne isprave kojima se dokazuje radno mesto i radno iskustvo, bez kršenja relevantnih akata za zaštitu podataka o ličnosti);
- Izveštaj Kosovskog penzijskog štednog fonda (TRUST-a)** za odgovarajući period ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje radnog iskustva ili poresko uverenje Poreske administracije (PAK) kada se izveštaj Trusta zakonski ne primenjuje;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju da budu zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova;

Procedura apliciranja:

- Zadnji rok za podnošenje aplikacija je **8 mart 2024** godine.
- Aplikacija se može podneti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik apliciranja neće biti uzet u razmatranje.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti sa zvanične stranice: www.bqk-kos.org



Në mbështetje të nenit 21.1 dhe nenit 25 pika h) të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 15.06.2008, nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 30.05.2021, lidhur me nenin 22 të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 19.04.2018, e duke u bazuar në vendimin e Komisionit të Auditimit me nr. të protokollit 18/24 të datës 21.02.2024, N.P.L "Përparimi" Sh. A. me datë 21.02.2024, shpall:

KONKURS PUBLIK

(Për plotësimin e vendit të lirë për pozitën e punës "Zyrtar për Auditim të Brendshëm")

I. Titulli: Zyrtar për Auditim të Brendshëm

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar në periudhë tre (3) vjeçare, me mundësi të vazhdimit.

Përgatitja profesionale: Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike apo fusha të tjera të studimeve relevante për sektorin që do të auditohet.

Përvoja e punës: Së paku tri (3) vite në kontabilitet dhe auditim.

I raporton: Komisionit të Auditimit.

Koeficienti i pagës: caktohet me vendim të Bordit të Drejtorëve.

Kushtet e veçanta:

- Të përmbushë kriteret për zyrtarë të ndërmarrjes sipas nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;
- Të përmbushë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, (ii) t'i plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) (iii) të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;
- Të jetë ekspert i certifikuar në kontabilitet ashtu si kërkohet me nenin 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;
- Të jetë Auditor i Certifikuar në sektorin publik, certifikatë e cila duhet të jetë e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave, ashtu si kërkohet me nenin 22 Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

- Njohja e mirë e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, me theks të veçantë Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe plotësim ndryshimet, Ligjin për Shoqëritë Tregtare, Ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Ligjin nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, si dhe ligjet të tjera që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e financave publike.
- të ketë aftësi organizative dhe shkathtësi komunikimi;
- njohja e programeve Microsoft Office;
- njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- të mos jetë i dënuar ose nën hetime.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Përpilimi i planit të auditimit të brendshëm të ndërmarrjes konform objektivave të kontrollit të brendshëm, politikave dhe procedurave të bazuara në legjislacion të aplikueshëm.
- Auditimi i planeve investive financiare, planit vjetor dhe buxhetin vjetor.
- Auditimi i pasqyrës vjetore të bilancit, deklaratat e fitimeve dhe humbjeve, si dhe deklaratave financiare.
- Vlerësimi profesional i shfrytëzimit efektiv të burimeve të ndërmarrjes dhe dhënia e rekomandimeve adekuate për komisionin e auditimit, përkatësisht menaxhmentin e ndërmarrjes.
- Bën kontrollin financiar të pasurisë dhe parave të gatshme
- Udhëheqë dhe organizon auditimin e brendshëm.
- Zbaton të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm.
- Kryen detyrat e përcaktuara nga Komisioni për Auditim, dhe
- Kryen edhe punët tjera të nevojshme.
- Udhëheqë dhe drejton të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm.
- Për punën e tij i përgjigjet Komisionit të Auditimit.

Aplikacionit duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A (I cili merret në zyrën e Sekretarit të ndërmarrjes);
- Një deklaratë nën betim të nënshkruar nga kandidati se i plotëson kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.1 dhe 17.2. (Kjo deklaratë merret në zyrën e Sekretarit të Ndërmarrjes);
- Rezume për jetëshkrimin e kandidatit;
- Letër Motivuese;
- Dëshmitë për kualifikimin Universitar (Diploma të sille e noterizuar);
- Certifikata për Auditor të Brendshëm të lëshuar nga organet përgjegjëse, e cila duhet të jetë valide (Vërtetim për validitetin e certifikatës);
- Certifikata me të cilën dëshmohet se është ekspert në kontabilitet e lëshuar nga organet përgjegjëse, e cila duhet të jetë valide (Vërtetim për validitetin e certifikatës);
- Dëshmitë për përvojën e punës;

- Kopjen e letërnjoftimit;
- Certifikatën nga Gjykata e cila dëshmon që nuk është e dënuar me aktgjykim të formës së prerë dhe certifikatën nga gjykata me të cilën dëshmon se nuk është nën hetime, të dy (2) dokumentet të sillen në formë origjinale (jo më të vjetra se 6 muaj);.

Konkursi mbetet i hapur tridhjetë (30) ditë nga dita e publikimit.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim dhe deklaratën nën betim mund ta marrin dhe ta dorëzojnë në zyrën e Sekretarit të N.P.L "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtrri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Aplikacioni duhet të dorëzohet në një kuvertë e cila duhet të jetë e mbyllur.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe e-mail adresën. Shpallja është e hapur nga data 23.02.2024 deri me datë 25.03.2024 në ora 16:00.

N.P.L "Përparimi" Sh. A në Vushtrri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Për informata shtesë mund të kontaktoni në këtë nr. tel. 044 - 157 - 075.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT


SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



U prilogu çlani 21.1 i çlani 25 taçka h) Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća objavljena u Službenom listu Republike Kosovo 15.06.2008, član 13 Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća objavljena u Službenom listu Republike Kosovo 30.05.2021, u vezi sa članom 22 Zakona br. 06/L-021 za unutrašnju kontrolu javnih finansija objavljen u Službenom listu Republike Kosovo dana 19.04.2018, a na osnovu odluke Komisije za reviziju br. protokola 18/24 od 21.02.2024, godine N.P.L. "Përparimi" Sh. A, od 22.02.2024, saopštava:

JAVNI KONKURS

(Za popunu konkursa za radno mesto „Službenik za internu reviziju“)

I. Naslov: Službenik za unutrašnju reviziju

Broj izvršilaca: 1

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Trajanje imenovanja: Na određeno vreme od tri (3) godine, sa mogućnošću produženja.

Stručna priprema: Univerzitetska diploma iz ekonomije, prava, javne uprave, javnih finansija ili drugih oblasti studija relevantnih za sektor koji će biti predmet revizije.

Radno iskustvo: Najmanje tri (3) godine u računovodstvu i reviziji. Izveštava: Odbor za reviziju.

Koeficijent plate: Utvrđuje se odlukom Upravnog odbora.

Posebni uslovi:

- Za ispunjavanje kriterijuma za službenike kompanije prema članu 13. Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća;
- Da ispunji kvalifikacione uslove prema članu 17.1, (ii) da ispunji kriterijume nezavisnosti prema članu 17.2, tačke (d), (f), (j), (k) i (l) (iii) Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća;
- Da bude ovlašćeni stručnjak za računovodstvo u skladu sa članom 13. Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća;
- Biti ovlašćeni revizor u javnom sektoru, sertifikat koji mora da izda Ministarstvo finansija ili sertifikat za internog revizora u javnom sektoru od bilo koje relevantne međunarodne ili domaće institucije u skladu sa kriterijumima koje izdaje ministar finansija, kao i propisano članom 22. Zakona br. 06/L-021 za unutrašnju kontrolu javnih finansija.
- Dobro poznavanje zakona i propisa koji su na snazi, sa posebnim osvrtom na Zakon o javnim preduzećima, Zakon o privrednim društvima, Zakon o unutrašnjoj kontroli javnih

finansija, Zakon br. 06/L-032 o računovodstvu, finansijskom izveštavanju i reviziji, kao i drugi zakoni koji se odnose na unutrašnju kontrolu i upravljanje javnim finansijama.

- Imati organizacione sposobnosti i komunikacione sposobnosti;
- Poznavanje Microsoft Office programa;
- Poznavanje stranih jezika je prednost;
- Da nije osuđen ili pod istragom.

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Sastavljanje plana interne revizije kompanije u skladu sa ciljevima, politikama i procedurama interne kontrole na osnovu važećeg zakonodavstva.
- Revizija planova finansijskih investicija, godišnjeg plana i godišnjeg budžeta.
- Revizija godišnjeg bilansa stanja, bilansa uspeha i finansijskih izveštaja.
- Stručna procena efektivnog korišćenja resursa preduzeća i davanje adekvatnih preporuka revizionoj komisiji, odnosno menadžmentu preduzeća.
- Vršiti finansijsku kontrolu imovine i gotovine
- Vodi i organizuje internu reviziju.
- Sprovodi sve aktivnosti interne revizije.
- Obavlja poslove koje odredi Komisija za reviziju, i
- Takođe obavlja i druge neophodne poslove.
- Vodi i usmerava sve aktivnosti interne revizije.
- Za svoj rad odgovara Odboru za reviziju.

Iz prijavu se mora priložiti sledeće:

- Obrazac prijave za N.P.L. "Përparimi" Sh. A (koji se prima u kancelariji sekretara preduzeća);
- Izjava potpisana od strane kandidata da ispunjava kriterijume nezavisnosti prema članu 17.1 i 17.2. (Ova izjava se prima u kancelariji sekretara preduzeća);
- Životopis za biografiju kandidata;
- Motivaciono pismo;
- Dokaz o univerzitetskoj kvalifikaciji (diploma mora biti overena);
- Sertifikat za internog revizora izdat od strane nadležnih organa, koji mora biti validan (Uverenje o važnosti sertifikata);
- Uverenje o stručnom znanju za računovodstvo izdato;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Kopija lične karte;

- Potvrda suda kojom se dokazuje da nije osuđivan/a pravosnažnom presudom i uverenje suda kojim se dokazuje da nije pod istragom, oba (2) dokumenta moraju se doneti u originalu (ne starije od 6 meseci);

Konkurs ostaje otvoren trideset (30) dana od dana objavljivanja.

Zainteresovani kandidati mogu uzeti formular za prijavu i izjavu pod zakletvom i predati je kancelariji sekretara N.P.L. "Progres" Sh. A u gradu Vučitrn, ul. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici - filijala u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Prijavu se mora predati u koverti koja mora biti zatvorena.

Kandidati koji konkurišu moraju da unesu tačnu adresu, kontakt telefon i e-mail adresu. Oglas je otvoren od 23.02.2024 do 25.03.2024 u 16:00 časova.

N.P.L. "Progres" Sh. A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo. Za dodatne informacije možete se obratiti na ovaj broj. tel. 044 - 157 - 075.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene, dok će nepotpune prijave biti odbijene.

NJOFTIM MBI ZVOGLIMIN E KAPITALIT TË

SHOQËRISË

"Beverly Park Residences " LLC

NUI: 812035568

Në përputhje me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në Kosovë dhe të Marreveshjes dhe Statutit se Shoqërisë, të plotësuar dhe ndryshuara, Aksionari i shoqërisë "Beverly Park Residences" L.L.C. me seli në Fushë Kosovë, rruga Rruga Miradi e Epërme, Parcela 508-2, me numër unik identifikues 812035568 ("Shoqëria") ka nxjerr:


VENDIM PËR ZVOGLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË me datë 21/02/2024

Kapitali i shoqërisë zvogëlohet në vlerën prej 465,000.00 EURO përkatësisht nga vlera e regjistruar **3,758,000.00 Euro** në **3,293,000.00Euro**

Të gjithë Kreditorët e Shoqërisë kanë të drejtën që në afatin 21 ditor nga dita e publikimit të këtij njoftimi në shtypin ditor të drejtohen Shoqërisë me kërkesë për siguri shtesë ose kërkesë për mos-zvoglim të kapitalit. Kërkesat i drejtohen Shoqërisë përmes postës së rregullt në adresën:

"Beverly Park Residences" L.L.C. me seli në Fushë Kosovë, rruga Rruga Miradi e Epërme, Parcela 508-2.

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
"Ambienti" S.H.A PEJË
NR. 269
DATA 22.02.24



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A .Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas nenit 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ Nr. 07 / 2017, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A .Pejë me datë 22.02.2024, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

KONKURS

Pozita : 4 Pozita VOZITËS-/ I AUTOMJETEVE PËR BARTJEN E HEDHURINAVE
(4 shofer vendi i punë Pejë)

Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.

Ka këto detyra dhe përgjegjësi

- Drejton automjetin, kujdeset për rregullsin e tij dhe është përgjegjës për vozitjen e sigurt, duke i respektuar rregullat e komunikacionit.
- Kujdeset për higjienën dhe pastërtin e automjetit, pas kryerjes së punës bënë larjen e automjetit.
- Çdo ditë merr urdhëresën e punës nga Kryepunëtori në të cilën e shënon evidencën e punës dhe shpenzimeve
- Është i obliguar që në automjet të ketë në rregull aparatin për filxën zjarrit dhe pajset përcjellëse të domosdoshme në komunikacion.
- Me rastin e prishjes së automjetit vozitësi është i obliguar të benë ndreqje të vogla, si nderimin e gomës, pastrimin e filterit etj. të qëndroi pran automjetit në puntori dhe ti ndihmoimekanikut ose gomistit.
- Çdo mëngjez është i obliguar të kontrolloi sasinë e vajit, ujit dhe gjendjen e gomave në makinë.
- Është i obliguar që për prishjet në automjet me kohë të lajmëroi kryepunëtorin e vet drejtëpërdrejt.
- Në rast të prishjes së automjetit me të cilin punon është i obliguar që të drejton automjet tjetër dhe kryen edhe punë tjera me urdhëres të Kryepunëtorit apo Menaxherit të Operatives.
- Është i obliguar te menaxhoi dhe të mbaj nen kontrolle ekipin e punetoreve fizik.
- Kryen edhe punë tjera me urdhëres të Kryepunëtorit, Menaxherit të Operatives
- Për punën e vetë i përgjigjet drjtëpërdrejt Kryepunëtorit, Menaxherit të Operatives, Kyeshefit Ekzekutiv Kushtet:
 - Shkollimin e mesem
 - Përgaditje profesionale-voztësi kategorive përkatese
 - 2 (dy) vite përvojë pune.
 - Aftësi fizike dhe psikike te deshmuar
 - Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;

Mënyra e Aplikimit: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në ndërtesën e Ndërmarrjes "Ambienti" S.H.A Rr Xhem Sadrija pn në Pejë. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në pliko të mbyllur në të cilin duhet të shkruhet pozita për të cilën aplikon. Data e fundit për aplikim është më: 08.03.2024. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk ju kthehen. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Albulena Ethem nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 të sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- "Noble Marketing" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810117912.

- Bislim Bislimi shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Fazli Greicevci".

- Ruzhdi Rashiti shpall të pavlefshëm certifikatën e aftësimit profesional me numër protokolli: 5438/19 e lëshuar me 08.10.2019 në Ferizaj, drejtimi: Murator/Ndërtimtar.

- Eslem Gashi shpall te pavlefshme deftesat, certifikaten , diplomën Q.K. "11 Marsi " Prizren.

- Munir Anadoli shpall te pavlefshme deftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Nuridin Isljami shpall te pavlefshme 4 deftesat dhe diplomën Q.K."11 Marsi " Prizren.

- Taulant Gashi shpall te pavlefshme 4 deftesat Q.K "11 Marsi " Prizren.

- Nuhi Rexhepi shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi " Prizren.

- Hami Ramadan Bajraliu shpall të pavlefshme Diplomën e Universitetit të Prishtinës, drejtimi Ekonomik me nr. 742.

- Anita Uka shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore nga kl. parë deri të nëntën të shkollës "Nazim Gafurri" Prishtinë.

- Naser Shunjaku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike "Nexhmedin Nixha".

- D.P.H. "Burimi" shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330286147-Gjilan.

- Bulent Bytyqi shpall te pavlefshme 4 dëftesat shme " Ymer Prizreni "Prizren.

- Fikret Ajazaj shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Egzona Rustemi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. dhjetë (X), njëmbëdhjetë (XI) dymbëdhjetë (XII) si dhe Diplomën e Gjimnazit "Naim Frashëri" Shtime.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

